



Prishtinë, 7 tetor 2021
Kodi i ZRRE: V_1422_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 dhe 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Vendimin e ZRRE-së Nr. V_1028_2018 të datës 24 shtator 2018, lidhur me aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për periudhën e dytë rregulative 2018-2022, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT);

në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)** që do të mbulohen nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A. përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut për vitin relevant tarifor 2021.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga KOSTT për vitin relevant tarifor 2021 do të jenë **38,935,561 Euro**, prej të cilave, Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë përbënë **10,100,987 Euro**.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për KOSTT dhe për Fondin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës Nr. 03/2017 për Të Hyrat e OST/OT-së të nxjerr nga ZRRE.

- IV. Operatori Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A., duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifën për shfrytëzim të sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut, të përcaktuar me MAR-in sipas këtij vendimi.
- V. Tarifën e propozuar nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, të aprovuara nga ZRRE.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Tregut duke filluar nga 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11 dhjetor 2020 ka iniciuar azhurnimet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për KOSTT për vitin relevant tarifor 2021.
 - ZRRE me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga OST/OT ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
 - Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A (OST/OT) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 27 janar 2021 në ZRRE;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
 - Komentet e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut KOSTT SH.A (OST/OT) ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 7 shtator 2021.
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar 8 tetor 2021; dhe
 - Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KOSTT, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.